Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-239
Datë 08.05.2018

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 25.04.2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Validohet dhe akreditohet Qendra e Bukurisë "Coiffure School", në Prishtinë me adresë Rruga; Imzot Nikë Prela-1, për periudhën 25.04.2018 deri 25.04.2021 me kualifikimin:

1.1. Parukier/Parukiere, Niveli III sipas KKK me 75 kredi të AAP

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

- Të trajnohet dhe aftësohet me tutje ndihmës trajnuesja mbi teorinë e parukerisë.
- Të krijohet sistemi për të siguruar klient nga jashtë për kandidatët.
- Të inkoorporohet në materialin teorik të programit edhe teoria mbi shëndetin dhe sigurinë ne punë.
- Duhet të ekzistojë metoda e monitorimit të punës së trajnuesve.
- Të mundësohet dezinfektimi i mjeteve në vendet e punës së kandidatëve.

(Afati kohor: 30. 08. 2018)

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin ofrues/aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.
Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Coiffure School
- AKK

Kryetari i KD së AKK-së
Bedri Xhafa